



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit **40** pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, të datës 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2003, merr

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT PËR NDËRTIMIN E QENDRËS KULTURORE - SPORTIVE NË PRISHTINË TË DATËS 17.08.2000

- I. **ANULOHE**T, Vendimi për ndërtimin e Qendrës Kulturore –Sportive në Prishtinë, i marrë nga UNMIK-u, Administratori Rajonal, Administratori Komunal dhe Komuna e Prishtinës, më 17 gusht 2000.
- II. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR.351-1753 DT.09.10.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri

A R S Y E T I M

Kryeshefi i Ekzekutivit të Komunës së Prishtinës, më 12.09.2003, përmes shkresës, dërguar Kuvendit të Komunës, ka kërkuar që konform dispozitave të nenit **40** pika **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës të dt: 16.03.2001 të anulojë Vendimin për ndërtimin e Qendrës Kulturore-Sportive në Prishtinë të dt: 17.08.2000.

Propozimi është bërë në pajtim me dispozitat e nenit **52** pika **xii** e Statutit të Komunës së Prishtinës, duke theksuar se Vendimi i marrë nga UNMIK-u, Administratori Rajonal, Administratori Komunal dhe Komuna e Prishtinës, nuk është i zbatueshëm për arsye të moszgjidhjes së çështjes pronësore dhe juridike të tokës, që është dedikuar për ndërtimin e Qendrës, të mungesës së kontratës mbi ndërtimin, paisjen dhe udhëheqjen e Qendrës në mes të UNMIK-ut, “Saudi Jonit Relief Committee” dhe Komunës së Prishtinës, të mosformimit të “Bordit udhëheqës” për mbikëqyrje të ndërtimit të objektit, i përbërë nga përfaqësuesë të UNMIK-ut, të “Saudi Jonit Relief Committee”, të Stafit udhëheqës komunal dhe personaliteteve eminente nga lëmi shkencorë - shoqëror,

Çështja ka arritur në Kuvend, si kompetencë e pa deleguar për shqyrtim. Kuvendi në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2003, shqyrtoi propozimin e Kryeshefit të Ekzekutivit dhe konstatoi se propozimi është i bazuar, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.